



Në mbështetje të nenit 52, paragrafi 52.1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 45, paragrafi 45.2 i Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, dhe të nenit 4, pika 4.3 e Rregullores për procedurën e themelimit, përbërjes dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunën e Prishtinës, kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa të Kryeqytetit,

th ë r r e t

mbledhjen e dytë të Komitetit për Politikë dhe Financa, e cila do të mbahet më **27.03.2023** dhe do të fillojë në orën **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën nr. 37 (kati II) të Komunës së Prishtinës.

Për mbledhje propozon këtë

REND TË DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Raportimi i Kryetarit të Kryeqytetit për kontratat e shfrytëzimit të pronës komunale;
3. Propozimvendimi për bartjen e mjeteve nga viti 2022 në vitin 2023;
4. Propozimvendimi për caktimin e Komisionit për rifreskimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Kryeqytet, si dhe shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Kryeqytet;
5. Propozimvendimi për miratimin e Planit të veprimit për shërbime sociale në Komunën e Prishtinës 2023-2025;
6. Të ndryshme.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01- 060/01-57040/23, më 16.03.2023

KRYESUESI I KOMITETIT
Fehmi Kupina

